



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.702/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi kryesues, Milena Djeric dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Selman Qallapeku, kandidatit për Kuvend Komunal të Drenasit, nga Subjekti Politik Levizja Vetvendosje (LVV), paraqitur kundër Kryesuesit dhe Komisionerëve në vendvotimet-0322/E /0301E /0320/E, për shkak të Mungeses së votave gjatë ditës së Zgjedhjeve Lokale 2021, të mbajtura me datë 17.10.2021, në Seancën e Panelit të mbajtur me 22.10.2021 mori këtë.

V E N D I M

HUDHEN të pa lejuara ankesat: Anr.702/2021, Anr.703/2021, Anr.704/2021 të gjitha të datës 21.10.2021, paraqitur nga kandidati për Kuvend Komunal të Drenasit, Selman Qallapeku, nga Subjekti Politik Levizja Vetvendosje LVV, paraqitur kundër Kryesuesit dhe Komisionerëve të vendvotimeve:0322/E 0320/E, 0301/E, për shkak të mungeses së votave gjatë ditës së zgjedhjeve, për Zgjedhjet Lokale 2021, të mbajtura më datës 17.10.2021.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesat: Anr.702/2021, Anr.703/2021, Anr.704/2021, të gjitha të datës 21.10.2021, paraqitur nga kandidati për Kuvend Komunal të Drenasit, Selman Qallapeku, nga Subjekti Politik Levizja Vetvendosje (LVV), paraqitur kundër Kryesuesit dhe Komisionerëve të vendvotimeve në QV. 0322/E , QV. 0320/dhe QV. 0301/E, duke pretenduar se ka pasur mungesë të votave dhe dyshon se ka pasur vjedhje votash sidomos në QV.0301/E. Pretenduesi i ankesës kërkon rinumrim në këto Qendra të Votimit për arsye se i mungojnë votat e tij dhe për këtë ka dëshmitar familjar dhe koleg me të cilën e kanë përkrahur dhe mbështetur në të gjitha format gjatë fushatës dhe këta persona janë në gjendje të dëshmojnë që e kanë votuar dhe vota e tyre fatkeqësisht nuk figuron.

Si dëshmi për këtë ankesës i ka bashkangjitur Formularet e Rezultateve të kandidatit për Zgjedhjet e Asambles Komunale.

Paneli, pas shqyrtimit të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesat janë të pa lejuara

Paneli, paraprakisht ka vlerësuar se ankesat: Anr.702/2021, Anr.703/2021, Anr.704/2021, kanë përmbajtje dhe natyrë të njëjtë të shkeljes së pretenduar, paraqitës i të gjitha ankesave është kandidati për Kuvend Komunal të Drenasit, Selman Qallapeku, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetvendosje (LVV), dhe po ashtu të njëjtat janë paraqitur kundër parregullsive në Qendrat e Votimit, prandaj Paneli, bazuar në nenin 8 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: *“Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave kryesuesi i panelit vendimmarrës mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato ankesa të trajtohen me një vendim”*, bëri bashkimin e ankesave dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduar në ankesa përkitazi me mungesën e votave në qendrat e votimit në QV 0320/E, QV 0301E/, QV 0322/E, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procesit zgjedhor. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hedhë si të parakohshme ankesat e ankuesit. Hedhja e ankesave të kandidatit për Kuvend Komunal të Drenasit, Selman Qallapeku, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetvendosje (LVV), nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Paneli duke u mbështetur në Rregulloren Nr.02/2015, përkatësisht neni 6.4, me të cilën përcaktohet se: *“ankesa të cilat janë të pa lejuar dhe të pas afatshme PZAP-i, hudhë si të pa*

lejueshme” ankesa është e palejueshme për faktin se është paraqitur para afatit të paraparë ligjor.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së dhe nenit 6 paragrafi 4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa
A nr. 702/2021 më datën 22.10.2021**

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*

